



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 2353 / 7 Prot.

Patos më 04.08.2026.

PROCESVERBAL

MBI MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS SË MBLEDHJES SË DATËS 29.07.2026

I mbajtur sot më datë 29.07.2026 në orën 14:00 në sallën e mbledhjeve të Këshillit ku zhvillohet mbledhja e Këshillit të Bashkisë:

Prezent në fillimin e mbledhjes këta këshilltare:

1. Klaudio Alisinanaj
2. Lori Musaj
3. Artan Velçani
4. Armand Ahmetaj
5. Ertila Myrtaj
6. Elton Seraj
7. Smerald Hazizaj
8. Elmira Rama
9. Renaldo Shpata
10. Vjollca Kasaj
11. Novrus Toska

Takimi hapet nga kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj.

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak,

Pjesmarrja në mbledhje është 11 këshilltarë.

Mbledhja bazohet dhe zhvillohet në bazë të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore si dhe Rregullores për organizimin dhe funksionimin e këshillit bashkiak,

Lexojmë rendin e ditës

1- Miratimi i rendit të ditës.

2- Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 29.06.2026.

3- Informacion mbi vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 29.06.2026.

4- Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin qershor 2026”.

5- Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin qershor 2026”.

6-Projekt-vendim “Për miratimin e tavanëve përfundimtar të programit buxhetor afatmesëm 2027-2029”.

7-Projekt-vendim “Për miratimin e buxhetit shtesë 2026, në transfertën e pakushtëzuar sektoriale dhe transfertën e përgjithshme”.

8-Projekt-vendim “Për miratimin e projektit “Rikonstuksion i shkollës 9-vjeçare “Hekuran Maneku” dhe ndërtimi i palestrës, dhe bashkëfinancimi nga Njësia Vendore.”

9- Projekt-vendim “Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për vitin 2026 për mbrojtjen civile, për blerjen e një skrepi me zinxhir”.

10- Projekt-vendim “Për miratimin e Planit Lokal të Strategjisë për zhvillimin e turizmit për vitet 2026-2031”.

11- Kërkesë nr. 756 prot., datë 24.02.2026 për dhenie ndihme të menjëhershme.

Keni dijeni për rendin e dites, është formuluar në bazë të rregullores ka kaluar gjithë procedurat e caktuara.

Para se të kalojmë në votimin e rendit të ditës dua tju pyes nëse keni ndonjë kërkesë për të shtuar apo hequr nga rendi i ditës.

Miratohet me 11 vota pro, asnjë abstenim, asnjë kundër.

SEKRETARE

Refaela Xeba




Artan Xheco

Artan Xheco
Ertan Myrtaj
Cendrupaj

KRYETAR

Armand Ahmetaj



Yolca Lajaj
Lajaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 2353 Prot.
8

Patos më 04.08.2026

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.07.2026 në orën 14:00 në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dytë të rendit të ditës.

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 29.06.2026.

Armand Ahmetaj – Procesverbalin si material e keni pasur. Keni ndonjë verejtje, ndonjë kërkesë për korrigjimin e procesverbalit? Konsiderohet i miratuar në bazë të nenit 77 të rregullores.

SEKRETARE
Refaela Xeba

Artan Velcani
Erbila Myrtaj
Cupkurtaj

KRYETAR
Armand Ahmetaj

Vjollca Karaj
Jareff



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 2393 Prot.

Patos më, 04 08.2026

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.07.2026 në orën 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tretë të rendit të ditës.

Mbi informacionin për vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 29.06.2026

Armand Ahmetaj– Fjala për Refaelën

Refaela Xeba -Përshëndetje të gjithëve!

Në mbledhjen e datës 29.06.2026 u morën gjithsej 9 vendime nga nr. 30 deri në 38.

Vendimet janë zbardhur në afat dhe i janë përcjell drejtorive përkatëse për ekzekutim. Nga këto vendime, vendimi me nr. 33, 34 dhe 36 i është përcjell Prefekturës për verifikim dhe na ka ardhur përgjigja se vendimi me numer 33 dhe 34 janë në përputhje me ligjin ndërsa vendimi 36 nuk është akt normativ dhe për këtë arsye nuk është kompetenca e prefektit për tu shprehur.

Faleminderit!

SEKRETARE

Refaela Xeba

Artan Velami
Gjithë
Gjithë Myrtaj
Gjithë Myrtaj

KRYETAR

Armand Ahmetaj

Vollca Karaj
Karaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 228 / 3 Prot.

Patos më 04 08.2026.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.07.2026 në orën 14:00 në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së katërt të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin qershor 2026”.

Armand Ahmetaj- Kjo pikë ka kaluar në komisionin e ekonomisë, ja jap fjalën ekzekutivit . Nëse keni ndonë kërkesë që ta shpejtojmë si procedurë meqënëse i keni konsumuar gjithë hapat ligjor.

Armand Ahmetaj- Jeni të hapur për diskutime?

Armand Ahmetaj –Nëse s’kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e katërt Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin qershor 2026”.

Miratohet me 11 vota pro, abstenim ska, kundër ska

SEKRETARE

Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 2277 Prot.

3

Patos më 09 08.2026.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.07.2026 në orën 14:00 në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së pestë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin qershor 2026”.

Armand Ahmetaj- meqënëse kryetari grupit kërkoj që ta kajojmë direkt në votim.

Armand Ahmetaj – Kush është dakord?

Armand Ahmetaj –Nëse s’kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e pestë Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin qershor 2026”.

Miratohet me 11 vota pro, abstenim ska, kundër ska

SEKRETARE
Refaela Xeba

Artan Velioni
Gjergj
Erkiter Myrtaj
Gjergj

KRYETAR
Armand Ahmetaj

Vollca Kasaj
Jasari



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 2346 Prot.

Patos më 04 08.2026.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.07.2026 në orën 14:00 në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së gjashtë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për miratimin e tavanëve përfundimtar të programit buxhetor afatmesëm 2027-2029”.

Mimoza Shtëmbari- projektvendimi për miratimin e tavanëve përfundimtar vjen me një ndryshim në lidhje me vlerat e tavanëve pasi në udhëzimin plotësues që ka ardhur në korrik të 2026 kemi ndryshimet shtesë të burimeve . 6 mijë e 700 lekë në vitin 2027, 8 mijë 800 lekë për vitin 2028 dhe 66 mijë lekë për vitin 2029. Kjo shtesë në burime është kanalizuar dhe është shpërndarë te tavanaet për shpenzime personeli. Gjithashtu në tavanë janë reflektuar dhe ndryshime midis programeve për pjesën e vendimit nr. 17 që u miratua. Kemi reflektuar dhe ndryshimin që është mar me vendim këshilli për vitin 2026 shtesën që ka ardhur si transfertë e përgjithshme dhe sektoriale e cila do referohet më vonë. Këto janë ndryshimet në lidhje me tavanet paraprake dhe tavanet përfundimtare.

Lori Musaj – në mbledhjen e komisionit është diskutuar dhe kjo pikë e cili është argumentuar në përputhje me bazën ligjore dhe e kemi votuar me tre vota pro.

Armand Ahmetaj- Keni ndonjë diskutim tjetër?

Armand Ahmetaj – Nëse s’kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e gjashtë Projekt-vendim “Për miratimin e tavanëve përfundimtar të programit buxhetor afatmesëm 2027-2029”.

Kush është dakord?

Miratohet me 11 vota pro, abstenim ska, kundër ska

SEKRETARE
Refaela Xeba

KRYETAR
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 2348 / 3 Prot.

Patos më 04 08.2026.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.07.2026 në orën 14:00 në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së shtatë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për miratimin e buxhetit shtesë 2026, në transfertën e pakushtëzuar sektoriale dhe transfertën e përgjithshme”.

Mimoza Shtëmbari- Në datën 09.07 me aktin normativ nr. 02 është reflektuar shtesa për ndryshimin e vendimit të këshillit të Ministrave 536 për masën dhe shpërblimin e orëve për punonjësit e mbrojtës nga zjarri dhe shpëtimi. Për këtë na ka ardhur një shtesë rreth 1 milion 678 e cila i përket transfertës sektoriale dhe të përgjithshme e cila do të kalojë dhe është shpërndarë për të mbuluar shpenzimet për pagat dhe sigurimet shoqërore për kategoritë që është përcaktuar sipas VKM 436 i cili konsiston në orët shtesë, për festa, për ditët e pushimit, për rastet kur punonjësit marrin pjesë në fikjen e zjarrit dhe shpëtimit. Kjo është dhe te tavanet dhe është përfshirë në ndryshimet përfundimtare.

Lori Musaj – në mbledhjen e komisionit është diskutuar dhe kjo pikë e cili është argumentuar në përputhje me bazën ligjore dhe e kemi votuar me tre vota pro.

Armand Ahmetaj- Keni ndonjë diskutim tjetër?

Armand Ahmetaj –Nëse s’kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e shtatë Projekt-vendim “Për miratimin e buxhetit shtesë 2026, në transfertën e pakushtëzuar sektoriale dhe transfertën e përgjithshme”.

Kush është dakord?

Miratohet me 11 vota pro, abstenim ska, kundër ska

SEKRETARE
Refaela Xeba

KRYETAR
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 24104 Prot. 74

Patos më 09 08.2026.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.07.2026 në orën 14:00 në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tetë të rendit të ditës.

8-Projekt-vendim “Për miratimin e projektit “Rikonstuksion i shkollës 9-vjeçare “Hekuran Maneku” dhe ndërtimi i palestrës, dhe bashkëfinancimi nga Njësia Vendore.”

Mimoza Shtëmbari- Bashkia Patos është fituese për projektin “Rikonstuksion i shkollës 9-vjeçare “Hekuran Maneku” dhe ndërtimi i palestrës, dhe bashkëfinancimi nga Njësia Vendore,” i cili do të jetë me financim për vitet 2026-2028 dhe financimi do të mbulohet 85% nga Ministria e Arsimit dhe 15% nga Bashkia plus koston për 15% për bashkëfinancimin e projektit bashkia do të mbuloj dhe koston e

mbikqyrjes dhe kolaudit dhe në total bashkëfinancimi shkon në vlerën 27 milion e 47 mijë i cili është propozuar për tu mbuluar për vitin 2028 meqenëse financimi I shtrin efektet 26-28. Vlera e projektit është në total 160 milion e 318 mijë, 85% 136 milion e 270 mijë do ti mbuloj Ministria e Arsimit me financim 3 vjecar 26-28 dhe pjesën tjetër prej 27 milion do ta mbuloj bashkia.

Kryetari Bashkisë- tek shkolla Hekuran Maneku është parashikuar rikonstrukcion total i plotë, vendaja e paneleve diellore në mos gaboj 90 kilovat për uljen e kostove së energjisë elektrike, gjithashtu dhe ndërtimi i palestrës që do bëhet në krahun e djathtë të shkollës dhe një fushë futbollit që do jetë para shkollës. Projekt është goxha i mirë dhe funksional dhe gjithë pjesa e shkollës do të këtë sistem kondicionimi që do jetë në cdo klasë. Është rikonstrukcion total edhe ndryshim total dhe i fasadës dhe ndërtimi palestrës që do jetë i mbuluar dhe I fshushës futbollit që do të jetë i zbuluar.

Lori Musaj – në mbledhjen e komisionit është diskutuar dhe kjo pikë e cili është argumentuar në përputhje me bazën ligjore dhe e kemi votuar me tre vota pro.

Armand Ahmetaj- Keni ndonjë diskutim tjetër?

Armand Ahmetaj –Nëse s’kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e tetë Projekt-vendim“Për miratimin e projektit “Rikonstuksion i shkollës 9-vjeçare “Hekuran Maneku” dhe ndërtimi i palestrës, dhe bashkëfinancimi nga Njësia Vendore.”

Miratohet me 11 vota pro, abstenim ska, kundër ska

SEKRETARE
Refaela Xeba

KRYETAR
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 2348 / 3 Prot.

Patos më 04 08.2026.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.07.2026 në orën 14:00 në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së nëntë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për vitin 2026 për mbrojtjen civile, për blerjen e një skrepi me zinxhir”.

Për vitin 2026 për Bashkinë Patos fondi i kushtëzuar e kushtëzuar për Mbrojtjen Civile është vlerë 9,748,408 (nëntë milion e shtatëqindë e dyzetë e tetë mijë e katërqindë e tetë) lekë e ndarë në Kode produktesh “Shpenzime për marrjen e masave parandaluese, dhe vlere për të ndihmuar shtetasit banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme”

Me VKB nr. 34, datë 29.06.2026 është miratuar përdorimi i fondit prej 4,874,204 (katër milion e tetëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e dyqind e katër) lekë për rehabilitimin e pjesshëm të përroit, në lagjen “e Re”, “Dukas”, loti 2.

Në mbështetje të nenit 64 shkronja “c”, nenit 54, shkronja “dh” të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, pika 3 shkronja “ë” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 414, datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile” i ndryshuar, Ekipi i menaxhimit të mbrojtjes civile duke parë situatën në të cilën ndodhet, sektori i mbrojtjes nga zjarri i cili ka nevojë për një mjet skrep me zinxhirë. Duke marrë parasysh sipërfaqen territoriale të Bashkisë Patos, si dhe dy njësitë Administrative që me reformën territoriale ju bashkangjiten Bashkisë Patos, është shtuar puna dhe volumi i saj, pasi njësia Administrative Ruzhdie ka një terren të thyer malor dhe të pyllëzuar e cila klasifikohet me risk të lartë zjarresh. Aktualisht M.Z.SH posedon një mjet zjarrfikës me kapacitet 2500 litra ujë, një foristradë me 250 litra ujë dhe një autobot me kapacitet 12,000 litra ujë. Temperaturat e larta në kohë vere, si dhe papërgjegjshmëria e disa individëve kanë bërë që dhe në territorin e bashkisë Patos të ketë pasur raste të shtuara zjarresh. Për të qenë prezent në çdo kohë dhe në çdo situat për të shoqëruar zjarrfiksen dhe minimizuar dëmtet e mundshme që shkakton zjarri në kohë reale, është e domosdoshme blerja e një skrepi me zinxhirë. Ky skrep me zinxhirë duhet të jetë në gjendje të mirë dhe i kohës, pasi siç e përmendëm edhe më lartë terreni në të cilin do të operoj është malor dhe i thyer.

Nga testimi i tregut vlera e mjetit skrepi me zinxhirë sipas ofertave të marra (3 oferta) është në vlerën mesatare 6,000,000 (gjashtë milion) lekë. Nga kjo, vlera prej 4,500,000 (katër milion e pesëqind mijë) lekë do të mbulohet nga Fondi i Kushtëzuar për Mbrojtjen Civile dhe 1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) lekë do të mbulohet nga fondi i miratuar i buxhetit fillestar në zërin “Blerje skrepi”. Për arsyet që parashtruam më lartë:

Të miratojë përdorimin e fondit prej 4,500,000 katër milion e pesëqind mijë) lekë,

Kryetari i Bashkisë- duke qenë se nuk do blihen dy skrepa se ka qenë njëherë i miratuar me vendim këshilli n po thjesht po bëhet ndryshim fondi që do të përdoret për blerjen e skrepit. Duke qenë se do përdoret fondi akmc për blerjen e skrepit dhe jo fondin që ishte përdorur për nevojat e vet bashkisë i cili do të përdoret për bërjen e rrjetit të kanalizimeve në grizë lënginas e cila besoj do mbyllet deri në dhjetor të këtij viti. Thjesht është ndryshimi I vlerës dhe fondi që do të përdoret. Do përdoret fondi akmc dhe jo të ardhurat e bashkisë është e njejta gje që kemi miratuar para ca muaj, me pak fjalë nuk do blihen dy skrepa po një.

Artan Velçani- Me pak fjalë ne kemi parashikuar në buxhet një vlerë për të blerë këtë, kur themi skrep me zinxhir për të blerë këtë ca kemi parasysh?

Kryetari Bashkisë- Skrepi do jete më zinxhira metalikë

Artan Velçani-keni bërë specifikime për fuqinë motorrike? Duhet të ketë dhe specifikime të tjera si kovë, thikë etj

Lori Musaj – në mbledhjen e komisionit është diskutuar dhe kjo pikë e cili është argumentuar në përputhje me bazën ligjore dhe e kemi votuar me tre vota pro.

Elmira Rama- është planifikuar që ky mjet të ketë një funksion shumë dimesional dhe funksione të tjera apo do jetë vetëm për emergjencat Civile

Kryetari i Bashkisë-Skrepi do jetë vetëm për Emergjencat Civile pasi dhe pjesa me e madhe e fondit është nga emergjencat Civile ajo pjesë tjetër që është e bashkisë pjesën kryesisht do jetë për emergjencat civile, shumë pak do jetë për bashkinë.

Armand Ahmetaj- Keni ndonjë diskutim tjetër?

Armand Ahmetaj –Nëse s’kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e nëntë Projekt-vendim “ “Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për vitin 2026 për mbrojtjen civile, për blerjen e një skrepi me zinxhir”.

Kush është dakord?

Miratohet me 11 vota pro, abstenim ska, kundër ska


SEKRETARE

Refaela Xeba



KRYETAR

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 2349 Prot.

Patos më 09 08.2026.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.07.2026 në orën 14:00 në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dhjetë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për miratimin e Planit Lokal të Strategjisë për zhvillimin e turizmit për vitet 2026-2031”.

Albora Sulaj – Në zbatim të detyrimeve ligjore në fushën e turizmit, Bashkia Patos ka hartuar Planin Lokal të Strategjisë për Zhvillimin e Turizmit për vitet 2026 - 2031, i cili kaloi edhe në konsultim publik me grupet e interesit në datën 21.07.2026.

Ky dokument përbën një instrument të rëndësishëm planifikimi vendor, i cili synon ta pozicionojë turizmin, në funksion të diversifikimit ekonomik, promovimit të kapitalit natyror dhe kulturor, forcimit të identitetit lokal dhe rritjes së përfitimeve për komunitetin.

Në përmbajtje të planit janë analizuar faktorët kryesorë që ndikojnë në elemente të trashëgimisë kulturore, monumente kulti, peizazhe natyrore dhe burime ujore, si dhe elemente të trashëgimisë industriale që lidhen me historinë e naftës. Potenciali turistik i tyre qëndron jo vetëm te prania fizike, por edhe te aftësia për t’u interpretuar, lidhur në itinerare dhe menaxhuar në mënyrë të qëndrueshme.

Për periudhën 2026 - 2031 rekomandohet që në fazën e parë të zhvillimit të përzgjidhen disa asete prioritare, ku ndërhyrjet për interpretim, sinjalistikë dhe promovim do të prodhonin efekt më të shpejtë: Kalaja e Margëllicit si pikë identitare historike; rezervuari i Zharrezës dhe ujëvarat e Siqecës si destinacione natyrore; Manastiri i Shën Trifonit dhe Mekami i Drenies si asete me peshë simbolike e komunitare; si dhe disa ferma/ullishte/sera të përzgjedhura si bazë për përvoja agroturistike. Përzgjedhja graduale e aseteve është e rëndësishme për të shmangur shpërndarjen e burimeve dhe për të ndërtuar një produkt të fokusuar, të besueshëm dhe të menaxhueshëm.

Promovimi i Patosit si destinacion kërkon ndërtimin e një narrative të qartë dhe të dallueshme. Brendi i destinacionit duhet të mbështetet në identitetin e shumëfishtë të territorit: natyrë, histori, bujqësi dhe industri. Për këtë arsye rekomandohet krijimi i një profili të unifikuar komunikimi, me materiale vizuale, përmbajtje digjitale, hartë të aseteve, kalendar eventesh dhe histori të shkurtra interpretuese që mund të përdoren në rrjete sociale, në faqet zyrtare dhe në platformat kombëtare të promovimit.

Për sa më sipër, i kërkojmë Këshillit të Bashkisë Patos miratimin e Planit Lokal të Strategjisë për Zhvillimin e Turizmit për vitet 2026 - 2031.

Artan Velçani- A vijnë turist në territorin tonë.

Albora Sulaj- Po vijnë në zonat malore.

Armand Ahmetaj- Keni ndonjë diskutim tjetër?

Armand Ahmetaj –Nëse s’kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e dhjetë Projekt-vendim “Për miratimin e Planit Lokal të Strategjisë për zhvillimin e turizmit për vitet 2026-2031”.

Kush është dakord? Miratohet me 11 vota pro, abstenim ska, kundër ska.

SEKRETARE

Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 756 Prot.

Patos më 09 08.2026.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.07.2026 në orën 14:00 në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës njëmbëdhjetë të rendit të ditës.

11- Kërkesë nr. 756 prot., datë 24.02.2026 për dhenie ndihme të menjëhershme

Armand Ahmetaj- Kemi të bëjmë me një rast të një sëmundje të rëndë Kjo kërkesë ka kaluar në komisionin e ekonomisë dhe të shëndetësisë, në të dyja komisionet ka marrë dritën jeshile. Ne komisionin e ekonomisë ka kaluar për vlerën që do të ketë.

Lori -musaj- në mbledhjen e komisionit kemi diskutuar mbi kërkesën që ma ka ardhur për ndihmën ekonmike, kemi diskutuar me ekzekutivin dhe kemi rënë dakord që të japim vlerën 150 milje lekë nga fondi rezerve

Armand Ahmetaj- 150 milje lekë të reja pra.

Armand Ahmetaj- Keni ndonjë diskutim tjetër? Armand Ahmetaj –Nëse s’kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën 11. Qytetarja quhet Raziko Kapllanaj.

Kush është dakord?

Miratohet me 11 vota pro, abstenim ska, kundër ska

SEKRETARE

Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj